

Guximi për të thyer kufijtë

GUSHT 16, 2017 - 7:46 PM



Ilire Zajmi

Lucie Léanne “Kufiri” roman poetik, përktheu nga frëngjishtja, Anila Xhekaliu, Buzuku, Prishtinë 2016

Për Milenën, personazhin kryesor të romanit poetik “Kufiri” të autores franceze Lucie Léanne, koha ndalon së ekzistuari një ditë nëntori, kur ajo shtrohet në një spital për të sëmurët mendërisht.

Milena, e cila dallon nga të sëmurët e tjerë të spitalit, ndihet e terrorizuar nga trajtimi i rëndë që iu bëhet të sëmurëve në këtë spital.

Ajo e ka të vështirë të kapërdijë dhunën e ushtruar, shkeljen e dinjitetit njerëzor, brutalitetin e infermiereve dhe sjelljen e psikiatrit të spitalit.

Duke përshkruar mënyrën e jetës në këtë spital, si të jetuarit në një “akullnajë” përmes Milenës, autorja përdor këtë metaforë duke na rrëfyer se jeta mund të jetë mizore, të vendoset në dorën

e dikujt që bëhet edhe më i "çmendur" se sa vet të sëmurët që janë shtruar aty për shërim, duke fshirë nga vetja e tyre kështu çdo vlerë njerëzore e humane. Kjo sjellje pikërisht ndikon që jeta e Milenës dhe pacientëve të tjerë të shtruar në spital, të përjetohet si akullnajë antarktiku, që shkrihet nga pak përditë, që ka aq shumë ftohësi e vrer sa të ngjeth mishtë. E përtej metaforës së akullnajës, simbolit të pakove të harruara në kohë e hapësirë, masave të paforma, viteve të kaluara nën pushtetin e ilaçeve qetësuese, është gjakimi për mungesën e lirisë.

Të çmendurit e mbyllur në këtë spital, janë të burgosur brenda mureve, që ëndërrojnë ndonjë këngë zogu, barin e mëndafshtë, fluturat e purpurta, lëndina të gjelbëruara. Aty ndodhet kufiri i Milenës, Zherarit, Sekotinës, Karmenit e personazheve të tjera të romanit të Lucie Léanne, që janë mbyllur në spitalin e të sëmurëve mendërisht.

LUCIE LÉANNE

— ROMAN —

KUFIRI





Përktheu nga frëngjishtja

ANILA XHEKALIU

BUZUKU

Përderisa kufirin imagjinar por edhe atë real, mes çmendurisë dhe arsyes e ndan një fije e padukshme, për dikë në ëndërr shndërrohet mbledhja e lajthive të fshehura në muret e spitalit, llampadarët ndriçues apo vardisje zonjave të bukura të shtruara në spital, për Milenën ëndrra ka vetëm një synim, të arratiset nga ai dreq vendi.

Milena, kjo vajzë e re e vetëdijshme për situatën në të cilën ndodhet dhe pasojat afatgjate të saj, ka krijuar Itakën në kokën e saj. Prandaj, nuk resht së kërkuari mundësinë për të fituar lirinë e mohuar.

“Përtej këtyre mureve, është parku dhe përtej parkut... liria. Ishte harruar liria, e strukur që prej shumë kohe në gropën e trurit tim, larg, në fund të pavetëdijes, duke u endur korridoreve nëntokësore, e hedhur, e burgosur e substancave kimike, e pengesave mendore”(kreu i dytë fq.39).

Kjo liri, synohet të fitohet me çdo kusht, qoftë edhe me çmimin e dhimbshëm për të mos e gëzuar kurrë. Por aftësia e personazhit kryesor të romanit, dhe ndihma e ofruar nga Zherari, një i sëmurë tjetër, bëjnë që plani të ketë sukses, dhe që Milena të ndjej shijen e gjakuar të lirisë.



“Kufiri” është një rrëfim që të trondit që në faqet e para, që të zbulon sa e trishtë dhe e egër mund të jetë jeta njerëzore brenda një spitali të sëmurësh. Historia e Milenës, na mëson sa i guximshëm është njeriu që nuk pajtohet me fatin e tij, që nuk pajtohem me situatën në të cilën ndodhet qoftë ajo edhe e të qenit e shtruar në një spital të sëmurësh mendësisht, dhe çfarë betejash mund të bëjë për të thyer kufinjte.

I shkruar me një gjuhë të pasur poetike, romani lexohet me një frymë, dhe të fut në filozofinë e absurdit. Aty ky qënia njerëzore objektifikohet në një diagnozë psikiatrike “i sëmurë mendor”. Aty ku dinjiteti njerëzor mbytet me qetësues.

Gjuha e përdorur e romanit është plot me ironi të hollë, humor e satirë.

Shkrimtarja Lucie Léanne ia ka arritur që ti ofrojë lexuesit një thriller psikologjik, duke trajtuar një temë krejtësisht të veçantë, jo vetëm në letërsinë franceze.

*Lucie Léanne, është poete dhe romanciere, autore e romanit “I çmenduri pas letërsisë”, (Les lettres du monde, 1999) dhe përmbledhjes me poezi, Dromca jete (Le Manuscrit, 2001). Ky është libri i saj i tretë. / **KultPlus.com***

SHPËRNDATJE ARTIKULLIN



TË FUNDIT

Guximi për të thyer kufijtë

GUSHT 16, 2017

(<http://kultplus.com/libri/guximi-per-te-thyer-kufijte/>)

*Kur Pranvera Basha Badivuku takohet me babanë
e saj pas 20-të vitesh*

GUSHT 16, 2017

(<http://kultplus.com/libri/kur-pranvera-basha-badivuku-takohet-babane-e-saj-pas-20-te-vitesh/>)

*Poetë të shquar ndërkombëtar në Festivalin e
Poezisë në Rahovec*

GUSHT 16, 2017

(<http://kultplus.com/libri/poete-te-shquar-nderkombetar-ne-festivalin-e-poezise-ne-rahovec/>)

*Një botim me vlerë për folklorin shqiptar në
Maqedoni*

GUSHT 16, 2017

(<http://kultplus.com/libri/nje-botim-vlere-per-folklorin-shqiptar-ne-maqedoni/>)

TË NGËJAËSHME



*Mesnatë dimri tirane
Isabel Allende mbushi 75 vjeç, 'Shtëpia e
shpirtrave' mbetet sukcesi më i madh i saj*

KORRIK 6, 2017



*Së shpejti edicioni i 36-të i Seminarit
Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe
Kulturën Shqiptare*

[\(http://kultplus.com/libri/isabela-allende-mbushi-75-vjec-shtepia-e-shpirtrave-mbetet-suksesi-madh-saj/\)](http://kultplus.com/libri/isabela-allende-mbushi-75-vjec-shtepia-e-shpirtrave-mbetet-suksesi-madh-saj/)

[\(http://kultplus.com/libri/se-shpejti-edicioni-36-te-seminarit-nderkombetar-per-gjuhen-lettersine-dhe-kulturen-shqiptare/\)](http://kultplus.com/libri/se-shpejti-edicioni-36-te-seminarit-nderkombetar-per-gjuhen-lettersine-dhe-kulturen-shqiptare/)

RRETH NESH (/KULTPLUS/RRETH-NESH)

*KultPlus është gazetë online për art dhe kulturë, e para dhe e vetmja në të gjithë hapësirën shqiptare. Në KultPlus mund të lexoni lajmet më të fundit për artin dhe kulturën shqiptare, atë të rajonit dhe të botës. Përpos lajmeve, në KultPlus mund të lexoni tema të ndryshme, intervista, opinione...
Me KultPlus, bota e juaj është më e bukur!*

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga portali KultPlus

NA NDIQNI

f (<https://www.facebook.com/kultpluscom/>)

t (<https://twitter.com/kultplus?lang=en>) **y** **i**

INFO@KULTPLUS.COM ([MAILTO:INFO@KULTPLUS.COM](mailto:INFO@KULTPLUS.COM))

LIGJET

LIGJET

LIGJI PËR TEATRIN

LIGJI PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

LIGJI PËR TEATRIN